

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Oficer sigurie

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Oficerët e Sigurisë janë përgjegjës për ruajtjen e sigurisë së rrugës dhe sigurimin e mbikëqyrjes.

❖ DETYRAT KRYESORE

Përgjegjësitë specifike përfshijnë:

- Garantimi i sigurisë së personelit, asetëve dhe objekteve të kabinave të pagesës.
- Monitorimi i sistemeve të mbikëqyrjes dhe reagimi i menjëhershëm ndaj incidenteve dhe shkeljeve të sigurisë.
- Bashkëpunimi me menaxherin e sigurisë për të zbatuar protokollet dhe procedurat e sigurisë.
- Trajtimi profesional i incidenteve të sigurisë dhe emergjencave, me fokus në zgjidhjen e shpejtë.
- Mbajtja e të dhënave gjithëpërfshirëse të aktiviteteve të lidhura me sigurinë dhe raportimi te Menaxheri i Sigurisë.
- Ndihma në zhvillimin dhe zbatimin e masave të sigurisë, duke përfshirë kontrollin e aksesit dhe planet e reagimit emergjent.

Raporton tek: Menaxheri i Sigurisë

❖ KRITERET KRYESORE

- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm
- Preferohet të ketë certifikim për punonjes sigurie
- Te kete experience te meparshme pune si punonjes sigurie
- Certifikim për Ndihmen e Pare
- Te zoteroje lejen e drejtimit të mjetit

Te gjithë te interesuarit, janë të lutur që të dergojnë CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose të plotesojnë formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 10 Maj 2024, ora 17:00**.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi "Mbrojtjen e të dhënave personale"